



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 174

Tiranë – E mërkurë, 10 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 653, datë 3.11.2021	Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të specifikimeve teknike të gradave, si dhe përcaktimin e simboleve, të uniformës, të shenjave dalluese dhe normave të veshmbathjes së punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë..... 15549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 3.11.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2, të kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin e ndërtimit të <i>bypass</i> -it të Fierit, ratifikuar me ligjin nr. 80/2012..... 15572
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 3.11.2021	Për përcaktimin e llojeve të qendrave/institucioneve shëndetësore, publike apo private, si dhe të kriterëve që ato duhet të plotësojnë për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë, në fushën e shëndetësisë 15575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 3.11.2021	Për kriteret e hartimit të planeve të menaxhimit dhe për përcaktimin e ekosistemeve, habitateve e llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje..... 15577
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 343/5, datë 5.11.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, nyja e Milotit”..... 15578



VENDIM

Nr. 653, datë 3.11.2021

Lidhja nr. 1

**PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, TË
FORMËS DHE TË SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE TË GRADAVE, SI DHE
PËRCAKTIMIN E SIMBOLEVE, TË
UNIFORMËS, TË SHENJAVE DALLUESE
DHE NORMAVE TË VESHMBATHJES SË
PUNONJËSVE TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, pika 2, 58, pika 2, dhe 59, pika 3, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Flamuri dhe stema e Gardës së Republikës janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Uniforma për punonjësit e Gardës së Republikës është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për shërbime të veçanta punonjësit e Gardës përdorin veshje civile.

4. Shenjat dalluese të Gardës së Republikës janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Normat e furnizimit me veshmbathje për punonjësit e Gardës së Republikës janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Vendimi nr. 136, datë 11.2.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e uniformës, të formës dhe elementeve të gradave e të shenjave dalluese të efektivave të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PARAQITJA, FORMA DHE SPECIFIKIMET
TEKNIKE TË GRADAVE TË GARDËS
SË REPUBLIKËS**

Gradat e Gardës së Republikës ndahen në dy grupe, grada supi dhe grada gjoksi.

Lënda e parë që do të përdoret për gradat është tekstil ngjyrë e zezë, me përzierje (+/-3%); 70 % poliestër e 30 % viskoz. Pesha e tekstilit 210–220 gr/m².

Elementet e gradave duhet të jenë të rregullta, pa deformime të konfiguracioneve apo shkëputje të pjesëve të qëndisura.

Sipas neneve 33, 34, të ligjit 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, emërtimet e gradave sipas klasifikimit, janë si më poshtë:

1. Punonjës i nivelit bazë:

- a) inspektor;
- b) inspektor i dytë;
- c) inspektor i parë;

2. Punonjës i nivelit të mesëm:

- a) nënkomisar;
- b) komisar;
- c) kryekomisar;

3. Punonjës i nivelit të lartë:

- a) drejtues;
- b) drejtues i parë;

4. Punonjës i nivelit madhor:

- a) drejtues i lartë;
- b) drejtues madhor;

Paraqitja, forma dhe përshkrimi i elementeve përbërëse të gradave të Gardës së Republikës, sipas emërimit dhe klasifikimit të niveleve në rendin hierarkik rritës, janë si më poshtë:

A. GRADA SUPI

Gradat e supit janë në formë spaleti, me përmasa 14.5 cm x 4.9 cm, baza e gradës është e drejtë ndërsa maja është në formën e një trekëndëshi dybrinjëshëm me lartësi 1.5 cm. Në të gjithë perimetrin e saj, grada kornizohet nga një shirit i qëndisur me fill me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 2 mm. Elementet e gradës, shiritat (kalaja e stilizuar, me dhe pa bedena) vendosen 3 mm larg nga shiriti me ngjyrë të kuqe (baza e fundit e gradës) dhe të baraslarguar 3 mm nga njëri-tjetri. Yjet vendosen në vijë të drejtë mbi gradë.

Të gjitha elementet e gradës, për çdo nivel grade, qëndisen me fill me ngjyrë të artë, në copë tekstili të punuar me fill ngjyrë të zezë, e përforcuar nga brenda me material të posaçëm plastik për të mos u deformuar. Nga ana e poshtme, grada pajiset me një gjuhës të fiksuar nga ana drejtkëndore e saj, e cila shërben për montimin e gradës në sup, nëpërmjet dy ylyqeve të qepura në secilin sup në vend të spalinave, duke u mbërthyer me perçinë në formën e kopsës së vogël të Gardës.


Për punonjës të nivelit bazë

Grada është në formë spaleti, në të gjithë perimetrin e saj kornizohet nga shiriti i qëndisur me fill me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 2 mm. Elementi bazë i gradave janë shiritat.

- Shiriti i parë, me lartësi 12 mm e gjerësi 4.5 cm, i stilizuar në formën e një kështjelle me tre rreshta (4 mm secili), është i njëjtë për të gjitha gradat e këtij niveli. Në shiritin e kalasë së stilizuar, mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut. Ky shirit vendoset 3 mm nga baza e fundit e gradës.

- Shiritat e tjerë janë në formë këndore (110°), me gjerësi 5 mm. Shiritat këndorë vendoset 12 mm nga shiriti i kalasë së stilizuar dhe 5 mm nga njëri-tjetri.

- Për gradën **“Inspektor”**, ka një shirit këndor.
- Për gradën **“Inspektor i dytë”** ka dy shirita këndorë.
- Për gradën **“Inspektor i parë”** ka tre shirita këndorë.



Për punonjës të nivelit të mesëm

Grada është në formë spaleti, në të gjithë perimetrin e saj kornizohet nga shiriti i qëndisur me fill me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 2 mm. Elementet bazë të gradave janë shiriti i kalasë së stilizuar, dhe yjet (me diametër 1.75 cm).


- Yjet vendosen në distancë 12 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar me bedena dhe 12 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën **“Nënkomisar”** një yll.

Për gradën **“Komisar”** dy yje.

Për gradën **“Kryekomisar”** tri yje.

- Shiriti i kalasë, me gjerësi 1.6 cm, është i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena, me 4 rreshta (4 mm secili), i cili vendoset 3 mm nga baza e fundit e spalinës. Në këtë shirit mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut.



Për punonjës të nivelit të lartë

Grada është në formë spaleti, në të gjithë perimetrin e saj kornizohet nga shiriti i qëndisur me fill me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 2 mm. Elementet bazë janë yjet (me diametër 2.5 cm) dhe dy shirita.

- Shiriti i parë, me gjerësi 4 mm, i stilizuar në formën e një kështjelle pa bedena, vendoset 3 mm nga baza e fundit e spalinës.


- Shiriti i dytë, me gjerësi 2 cm, i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena, me 5 rreshta (4 mm secili), vendoset 3 mm nga shiriti i parë. Në shiritin e kalasë mbivendosen dy çifte shpatash të

kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut.

- Yjet vendosen në distancë 12 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar me bedena dhe 12 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Drejtues” një yll.

Për gradën “Drejtues i parë” dy yje.



Për punonjës të nivelit madhor

Grada është në formë spaleti, në të gjithë perimetrin e saj kornizohet nga shiriti i qëndisur me fill me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 2 mm. Elementet bazë janë yjet (me diametër 3.25 cm) dhe tre shiritat.


- Dy shiritat e parë (4 mm secili) janë stilizuar në formën e një kështjelle pa bedena. Shiriti i parë vendoset 3 mm nga baza e fundit e spalines, shiriti i dytë vendoset 3 mm nga i pari.

- Shiriti kryesor, me gjerësi 2.4 cm, i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena, me 6 rreshta (4 mm secili), vendoset 3 mm nga shiriti i dytë. Në shiritin e kalasë mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut.

- Yjet vendosen në distancë 7 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar me bedena dhe 7 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Drejtues i lartë” një yll.

Për gradën “Drejtues madhor” dy yje.



B. GRADA GJOKSI

Gradat e gjoksit janë në formë drejtkëndëshi me dimensione 8.5 x 3 cm.

Elementet formuese të gradave të gjoksit, për të gjitha nivelet, janë në formë të njëjtë me ato të gradave të supit, sipas niveleve, ndërsa përmasat e elementeve të këtyre gradave janë në masën 60% të elementeve të gradave të supit.

Të gjitha elementet e gradave janë të qëndisura me fije në ngjyrë ari, në copë tekstili me ngjyrë të zezë. Këto grada vendosen në krahun e majtë të gjoksit mbi kapakun e xhepit, me anë të një velkrofi femër-mashkull. Grada, në të gjithë perimetrin e saj, kornizohet nga një shirit i qëndisur me fill me ngjyrë kuqe, me gjerësi 2 mm.

Për punonjës të nivelit bazë

Elementet bazë të gradave të gjoksit, për këtë nivel, janë shiritat.


- Shiriti bazë, me gjerësi 7 mm, i stilizuar në formën e një kështjelle me tre rreshta, është i njëjtë për të gjitha gradat e këtij niveli. Në shiritin e kalasë së stilizuar mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut. Ky shirit vendoset 2 mm larg nga baza e fundit e gradës.

- Shiritat këndorë 110°, me gjerësi 3 mm, vendosen 7 mm nga shiriti i kalasë së stilizuar dhe 3 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Inspektor” ka një shirit këndor.

Për gradën “Inspektor i dytë” ka dy shirita këndorë.

Për gradën “Inspektor i parë” ka tre shirita këndorë.



Për punonjës të nivelit të mesëm

Elementet bazë të këtyre gradave janë yjet (me diametër 1 cm) dhe shiriti i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena.


- Shiriti i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena, me gjerësi 1 cm (4 rreshta), vendoset 2 mm larg nga baza e fundit e gradës. Në shiritin e kalasë mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut.

- Yjet vendosen në distancë 7 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar dhe 7 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Nënkomisar” një yll.

Për gradën “Komisar” dy yje.

Për gradën “Kryekomisar” tri yje.



Për punonjës të nivelit të lartë

Elementet bazë të këtyre gradave janë yjet (me diametër 1.5 cm) dhe dy shiritat.


- Shiriti i parë me gjerësi 3 mm, i stilizuar në formën e një kështjelle pa bedena, vendoset 2 mm nga baza e fundit e gradës.

- Shiriti i dytë, me gjerësi 1.2 cm, është i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena me 5 rreshta. Në këtë shirit mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave, qëndron përkrenarja e Skënderbeut.

- Yjet vendosen në distancë 7 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar dhe 7 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Drejtues” një yll.

Për gradën “Drejtues i parë” dy yje.



Për punonjës të nivelit madhor

Elementet bazë të këtyre gradave janë yjet (me diametër 2 cm) dhe tre shiritat.


- Dy shiritat e parë, me gjerësi 3 mm secili, janë të stilizuar në formën e një kështjelle pa bedena dhe vendosen 2 mm larg nga baza e fundit e gradës dhe 2 mm nga njëri-tjetri.

- Shiriti i tretë, me gjerësi 1.5 cm, i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena me 6 rreshta. Në këtë shirit mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut.

- Yjet vendosen në distancë 4 mm nga shiriti me kështjellën e stilizuar dhe 4 mm nga njëri-tjetri.

Për gradën “Drejtues i lartë” një yll.

Për gradën “Drejtues madhor” dy yje.



Lidhja nr. 2

Forma dhe përshkrimi i stemës
së Gardës së Republikës

SIMBOLET E GARDËS SË REPUBLIKËS

Forma dhe përshkrimi i Flamurit
të Gardës së Republikës

Flamuri është me ngjyrë të kuqe, rrethohet nga një kordon dekorativ i artë, në qendër të saj ka shqiponjën e përdorur nga Garda në themelimin e saj, në vitin 1928.

Shqiponja me ngjyrë të zezë rrethohet nga një fill i hollë i verdhë, që e bën atë të evidentohet mbi sfondin e kuq, ajo mbështetet mbi një dekoracion floreal me ngjyrë të artë, të përdorur në emblemat shqiptare. Mbi shqiponjë është vendosur përkrenarja e stilizuar e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, me ngjyrë të artë. Në fund të flamurit është shkruar me ngjyrë të artë “GARDA E REPUBLIKËS”. Kompozimi i flamurit është bërë në mënyrë që të jenë të harmonizuar të gjithë elementet. Përdorimi i ngjyrave respekton trashëgiminë luftarake, kulturore e shpirtërore të popullit tonë. Përkrenarja e heroit tonë kombëtar është vendosur qëllimisht në pozicion ballor, për të bërë të mundur leximin e shkronjave të saj në ballë “BT”, “IN”. Kompozimi i shmanget seriotipisë. Ai respekton semantikën, rregullat dhe stilet araldike, duke bërë të lexueshme çfarë përfaqëson ky flamur.

Ngjyra e kuqe me kod: C0, M95, Y95, K0.

Ngjyra e zezë me kod: C0, M 100, Y 100, K0.

Ngjyra gold me kod: C0, M 45, Y 95, dhe K0.



Stema është në formën e një mburoje (shqyti) të përdorur gjerësisht në heraldikën e hershme dhe të tanishme Shqiptare, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale.

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, në qendër të saj është vendosur shqiponja e zezë dykrenare, e përdorur si simbol në krijimin e këtij formacioni. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Përkrenarja e Skënderbeut është vendosur në pamje ballore, për të bërë të mundur leximin e shkronjave “BT”, “IN”, duke respektuar semantikën, rregullat dhe stilet araldike të kurorave, e duke bërë më të lexueshme çfarë përfaqëson kjo përkrenare. Ajo i shmanget kopjimit përsëritës të saj, duke e bërë të veçantë për këtë institucion. Në këtë pozicion shikohet karakteri i saj laik e qytetar, fisnik e ushtarak. Emblema evidenton ndërthurjen e madhështisë me bukurinë që paraqet ky element në fushën e semantikës shqiptare.

Duke qenë se stema shërben edhe si shenjë krahu për gardistët, në pjesën harkore të shqytit është shkruar me germa kapitale “GARDA E REPUBLIKËS”.

Kompozimi i stemës ruan raporte të drejta midis shqytit dhe elementeve të tij. Përdorimi i ngjyrave respekton trashëgiminë shpirtërore kombëtare.

- Ngjyra e kuqe e shqytit simbolizon ngjyrën e flamurit kombëtar.

- Shqiponja në qendër të shqytit është ajo e themelimit të Gardës.

- Përkrenarja e Skënderbeut, e vendosur në qendër të shqiponjës, është një element kombëtar

që simbolizon krenarinë dhe qëndresën e popullit tonë.

- Ngjyra e artë, e përdorur në elementet e stemës përfaqëson:

Fuqinë dhe fisnikërinë;

Të mirën dhe përsosmërinë;

Diturinë dhe inteligjencën.

Lidhja nr. 3

PARAQITJA E UNIFORMAVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS

- A. Uniforma bazë në detyrë;
- B. Uniforma e shërbimit dhe stërvitjes;
- C. Uniforma ceremoniale;
- D. Uniforma për Truprojnë e Nderit;
- E. Uniforma e shoqërimit ceremonial me motoçikletë.

A. UNIFORMA BAZË NË DETYRË

Kostum uniforme (kapela, xhaketa, pantallona/fund për punonjëset femra).

Xhaketa e kostumit të uniformës: Pjesa e përparme dhe e pasme e xhaketës duhet të jenë tekstil me ngjyrë të zezë, me përbërje 70% lesh, 30% poliestër, me peshë 240 gr/m² ($\pm 3\%$). Xhaketa përpara mbyllet me katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm).

Në supe vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në formë spaletë. Në pjesën e përparme të mëngëve, 10 cm nga buzët e tyre, qepet fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të meshkujve, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e majtë.

Pantallonat tekstil me ngjyrë të zezë me përbërje 70% lesh, 30% poliestër, me peshë 240 gr/m² ($\pm 3\%$).

Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me dy xhepa të pasme me fileto të dyfishtë. Te tegelat anësore të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

Fund për punonjëset femra tekstil me ngjyrë të zezë me përbërje 70% lesh, 30% poliestër, me peshë 240 gr/m² ($\pm 3\%$).

Konstruksioni i fundit për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me gjatësi deri poshtë kupës së gjurit. Me qemer të përbërë nga një shtresë e vetme tekstili. Fundi duhet të pajiset me dy xhepa të përparmë diagonal. Te tegelat anësore duhet të qepet fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

UNIFORMA BAZË NË DETYRË DREJTUES MADHOR



UNIFORMA BAZË NË DETYRË DREJTUES I LARTË





UNIFORMA BAZË NË DETYRË
DREJTUES I PARË



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
DREJTUES



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
KRYEKOMISAR



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
KOMISAR



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
NËNKOMISAR



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
INSPEKTOR I PARË



UNIFORMA BAZË NË DETYRË
INSPEKTOR I DYTË




UNIFORMA BAZË NË DETYRË
INSPEKTOR



Kapela tekstil me ngjyrë të zezë me përbërje 70% lesh, 30% poliestër, me peshë 240 gr/m² ($\pm$ 3%). Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë. Për gradën “Drejtues madhor”, strehëza plastike i montohen në pjesën e përparme, në të gjithë gjatësinë e saj, dy shirita në formë gjethe lisi e punuar me fije ngjyrë ari. Për gradat “Drejtues”, “Drejtues i parë” dhe “Drejtues i lartë”, montohet një shirit në formë gjethe lisi e punuar me fije ngjyrë ari. Kapela në bashkimin e tepeleut me rrethin, përshkohet nga një fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

Drejtues MadhorDrejtues i Lartë, Drejtues i Parë, Drejtues


Meshkuj



Femra

Për nivelin e mesëm


Meshkuj



Femra

Për nivelin bazë

Meshkuj



Femra

UNIFORMA BAZË NË DETYRË

(me xhakavento dhe me pulovër)

Xhakavento është prej materiali me ngjyrë të zezë, me përbërje (+/- 3%), 50% lesh, 50% poliestër, masa 240 gr/m² (+/- 3%). Xhakavento është e hapur përpara, mbërthehet me kopsa dhe me zinxhirë në sallki. Xhakaventës, në fund, te jaka dhe mëngët, i vendoset llastik akreliku me ngjyrë të zezë. Në supe vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në formë spaletë.

Pulovri është prej materiali me përbërje ($\pm$ 3%), 50% lesh, 50% akrilik, ngjyrë e zezë, me masë: në trup 550 gr/m² ($\pm$ 3%), në jakë 600 gr/m² ($\pm$ 3%). Thurja në trup interlock, ndërsa në jakë punim llastik 1:1. Jaka e pulovrit duhet të

jetë në formë V-je. Në supe vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në formë spaletë.




UNIFORMA BAZË NË DETYRË

(me këmishë me mëngë të gjata dhe mëngë të shkurtra)

Këmishë me mëngë të gjata tekstil me ngjyrë të bardhë me përbërje ($\pm$ 3%), 80% pambuk, 20% poliestër, masa 120 gr/m² ($\pm$ 3%). Jaka duhet të jetë e tipit klasik me maja gjysmë të hapura. Këmisha përpara (në pjesën e sipërme) ka dy xhepa me kapak. Mbyllja e këmishës bëhet me 6 kopsa të vogla, me ngjyrë të bardhë. Këmisha për femra është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të meshkujve, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, dhe kopsave të cilat duhet të jenë në anën e majtë.

Këmishë me mëngë të shkurtra, tekstil me ngjyrë bardhë, me përbërje ($\pm$ 3%) 80% pambuk, 20 % poliestër, me masë 120 gr/m² ($\pm$ 3%). Këmisha përpara mbyllet me gjashtë kopsa të vogla. Këmisha duhet të ketë dy xhepa me kapak. Jaka duhet të jetë e tipit klasik me maja gjysmë të hapura. Në supe vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në forme spaletë. Këmisha për femra është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të meshkujve, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e majtë.

**Kravatë uniforme:**

Tekstil me ngjyrë të zezë 100 % poliestër, masa 110 gr/m² ($\pm 3\%$).



Këpucë gjysma për uniformën bazë në detyrë (për femra e meshkuj): materiali për pjesën e sipërme të përparme të këpucës verore duhet të jetë prej lëkure viçi (*boks*) me ngjyrë të zezë. Astari, meshin dhie. Shollë, gomë e presuar me relief kundër rrëshqitjes. Këpucët janë me majën e modeluar me maskaretë, me majë jo të theksuar.

(për meshkuj)



(për femra)



Këpucë me qafa dimri, materiali për pjesën e sipërme të përparme të këpucës duhet të jetë prej lëkure viçi (*boks*) me ngjyrë të zezë, cilësia e parë, 1.4 – 1.6 mm. Astari meshin dhie, cilësia e parë. Shtroja, tabani, celulozë kartoni fibre të presuar. Shollë, gomë e presuar me relief kundër rrëshqitjes. Forti dhe bombeja duhet të jetë prej material termoplastik, që nuk thyhet. Lidhëse tubolare me ekstremitete plastike.

**B. UNIFORMA PËR SHËRBIM E STËRVITJE**

Kostumi për shërbim e stërvitje (xhaketë, pantallona, kapelë), është material me ngjyrë të zezë me përbërje ($\pm 3\%$) 50% pambuk, 50% poliestër, masa 210 gr/m² ($\pm 3\%$), thurja ripstop.


Xhaketa është me jakë të hapur, në pjesën e sipërme të gjoksit ka dy xhepa të brendshëm me kapak. Një xhep pllakë me kapak në krahun e majtë të mëngës. Përparëset mbërthehen me 5 kopsa në sallki. Mëngët janë me ylyk, me velkrof femër-mashkull për shtrëngimin e tyre, 5 cm nga buza e tyre përshkohen nga një fileto e kuqe 3 mm. Mëngët në bërrija bëhen me fortesë nga i njëjti material. Në shpatulla përshkohet nga një fileto e kuqe 3 mm, në supë ka spaleta, të cilat në anësore përshkohen nga një fileto e kuqe 3 mm, deri në bashkimin me jakën.

Pantallonat janë me dy pensa (pala) përpara, dy xhepa të pjerrët në anësore dhe 2 xhepa pllakë prapa me kapak. Pantallonat në pjesën anësore të këmbës kanë dy xhepa pllakë me kapak. Pantallonat në pjesën e gjunjëve dhe të ndenjurrave bëhen me fortesë nga i njëjti material. Pantallonat në dy anësoret, në bashkimin e përparësive me pjesën e prapme të tyre, nga qemeri deri në fund të pantallonave, përshkohen nga fileto e kuqe 3 mm.

Kapela përbëhet nga pjesa e sipërme ose tepeleku, rrethi dhe streha. Streha është material plastik i hollë, i cili vishet me të njëjtin material si të kapelës, i kalohet tegel zbukurimi. Streha në pjesën e përparme përshkohet nga një shirit i kuq 3 mm. Pjesa e brendshme e kapelës vishet me astar të zi.

Bereta është material 100% lesh, ngjyrë e zezë, përbëhet nga pjesa e sipërme ose tepeleku dhe rrethi. Pjesa rreth e rrotull beretës ku bashkohet tepeleku me rrethin përshkohet nga një shirit i kuq 3 mm. Pjesa e brendshme e beretës vishet me astar të zi.

Kapela tip sport përbëhet nga kupola, streha dhe mekanizmi për shtrëngimin e kapelës. Kupola përforcohet me tekstil të kollarisur, në të ka katër vrima për ajrosje. Streha është material plastik i hollë me elasticitet të lartë dhe vishet me të njëjtin material si të kapelës, së cilës i kalohet fileto me ngjyrë të kuqe 3 mm.



Kapelë për uniformën e shërbimit dhe stërvitjes

(për të gjitha nivelet, femra dhe meshkuj)



Xhup 3/4 me veshje të ngrohtë: materiali bazë që përdoret përbëhet nga dy shtresa tekstili të përforcuar, me ngjyrë të zezë, me përbërje 100% poliestër, masa 240–260 gr/m² ($\pm 3\%$) dhe frazelinë termoadezive me përbërje 100% poliestër. Mbyllja e xhupit bëhet me anë të zinxhirit, të mbuluar me bordurë me gjerësi rreth 5 cm. Bordura mbyllet me anë të 7 perçinave metalike. Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të jashtëm, të pjerrët, me dy tegela sipër. Xhupi nga ana e brendshme ka një veshje të ngrohtë me astar me mbushje me filtër, të çmontueshme, e cila bashkohet me xhupin me zinxhir konfeksioni. Xhupi ka kapuç të çmontueshëm prej të njëjtit material. Në supe vendosen spalinat.



Doreza lëkure: Janë me ngjyrë të zezë, me material sheviro keci.



Jelek multifunksional: materiali me ngjyrë të zezë, me përbërje ($\pm 3\%$): 65% poliestër, 35% pambuk; masa 210 gr/m². Jelevu mbyllet me zinxhirë konfeksioni, përbëhet nga xhepa të fshehur (të brendshëm) dhe të dukshëm (të jashtëm).



Shall: Materiali 100% sintetik (atlas), ngjyrë të kuqe.

Pantallona verore: materiali me ngjyrë të zezë, me përbërje 62% poliestër, 35% viskozë, 3 % elastin, masa 210 gr/m² ($\pm 3\%$). Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal, dhe me dy xhepa të pasmë, me fileto të dyfishtë. Pantallonat duhet të kenë gjithsej 6 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Te tegelat anësore të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative me gjerësi 3 mm, me ngjyrë të kuqe.

Bluzë me mëngë të shkurta me tri kopsa



Përbërja ($\pm 3\%$): 50% pambuk, 50% poliestër me ngjyrë të zezë, me masë trupi 180 gr/m² ($\pm 3\%$); jaka dhe bordura e mëngës 200 gr/m² ($\pm 3\%$). *Thurja:* trupi - pique (syth irlandez); jaka dhe bordura e mëngës - punim llastik 1:1. Mbyllja përpara bëhet me tri kopsa të vogla me ngjyrë të zezë.

Bluzë e brendshme vere



Pamja përpara



Pamja prapa

Tekstil i trikotuar me përbërje 100% pambuk, ngjyrë e zezë. Masa 160 gr/m² ($\pm 3\%$). Jakë rrethore me gjerësi 3 cm, methurje llastik 2÷2. Bluza në gjoksin e majtë ka të stampuar stemën e Gardës. Në pjesën e pasme ka të stampuar mbishkrimin "GARDA".

Bluzë e brendshme dimri



Pamja përpara



Pamja prapa

Tekstil i trikotuar me push nga brenda, 100% pambuk, me ngjyrë të zezë. Masa $290 \text{ gr/m}^2 (\pm 3\%)$. Jaka rrethore gjysmë golfi me gjerësi 4–5 cm, methurje llastik 2+2. Bluza në pjesën e majtë të gjoksit ka të stampuar me ngjyrë të bardhë mbishkrimin “GARDA”.

Pelerinë shiu



Përbërja 100% najloni, e veshur me shtresë poliuretani me ngjyrë të zezë, masa $130 \text{ gr/m}^2 (\pm 3\%)$. Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardsesye dhe duhet të qepet me tekstil prej najloni të padepërtueshëm nga uji dhe era. Mbyllja e pelerinës duhet të bëhet me anë të 5 perçinave metalike. Me kapuç të lëvizshëm.

Rrip mesi dhe pantallonash



Rrip pantallonash, materiali të jetë sintetik, fill i thurur. Ngjyra e rripit e zezë. Mbërthimi me togëz metalike me ngjyrë të artë.

Rrip mesi, materiali tekstil i përforcuar me ngjyrë të zezë. Gjatësia 145 (± 3 cm). Gjerësia 4.5 cm. Mbërthimi i rripit realizohet me togëz ebaniti me ngjyrë të zezë. Rripi në të gjithë gjatësinë e tij ka

një shtresë përforcuese. Ai është i manovrueshëm në shtrëngimin apo lirimin e gjatësisë së tij, duke pasur edhe një siguresë për funksionimin e saj.

Këpucë shërbimi e stërvitjeje



Përbërja: faqet dhe fileta, lëkurë vaqet kromato tip U-je, me ngjyrë të zezë me pak shkëlqim. Astari, meshin dhie. Fjapa e presuar, gomë kompakte, tabani, soletë - natyrale (krupon), shollë gome e presuar me relief kundër rrëshqitjes.

C. UNIFORMA CEREMONIALE


(për gradat e nivelit madhor)

Kostumi ceremonial është ai i uniformës bazë në detyrë, duke i shtuar shiritin dekorativ (vetëm për gradat e nivelit madhor) dhe dekoratat shirit. Shiriti dekorativ (fjongo) është prej filli pambuk-poliesteri, i thurur, me ngjyrë ari, vendoset në anën e majtë të gjoksit nën spalinë dhe kapet në kopsën e parë të xhakëtës.

Shiriti për gradën “Drejtues madhor” është me tre kordonë, për gradën “Drejtues i lartë” me dy kordonë. Gradat e tjera nuk kanë shirit dekorativ.

UNIFORMA CEREMONIALE
DREJTUES MADHOR

UNIFORMA CEREMONIALE
DREJTUES I LARTË



D. UNIFORMA PËR TRUPROJËN E NDERIT



Kjo uniformë do të jetë verore dhe dimërore.

Uniforma verore përbëhet nga: kostumi (kapelë, xhaketë, pantallona), shirit dekorativ (fjongo), doreza të bardha, këpucë gjysma të zeza, rrip mesi ceremonial, rrip pantallonash.

Xhaketa do të jetë dopjopet, prej stofi terital veror, me ngjyrë të kuqe, me përbërje (+/- 3%), 70% lesh, 30% poliestër, masa 205 gr/m² (+/- 3%). Xhaketa është me jakë të zezë të mbyllur, e cila në anësore përshkohet nga një shirit me ngjyrë të kuqe 3 mm. Jaka në të gjithë gjatësinë e saj është e qëndisur me fije ngjyrë ari, me gjethe në formë kurore, që fillojnë nga përpara e bashkohen në mesin e jakës prapa. Xhaketa përpara mbyllet me 9 çifte kopsash të mëdha Garde. Xhaketa te supet ka dy spaleta pllake me ngjyrë të artë, në pjesën e përparme të mëngëve është qëndisur me fill të zi, shqiponja, në mesin e së cilës është qëndisur me fill ngjyrë ari, përkrenarja e Skënderbeut.

Pantallonat janë stof teritali veror, me ngjyrë të zezë, me përbërje (+/-3%), 70% lesh, 30% poliestër, masa 205 gr/m² (+/- 3%). Ka dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse ka dy pensa nga jashtë, në pjesën e prapme djathtas ka një xhep të brendshëm me fileto që mbyllet me kopsë. Pantallonat në të dy anësoret, në bashkimin e përparëseve me pjesën e prapme të tyre, përshkohet nga fileto të kuqe 3 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Kapela është stof teritali veror, me ngjyrë të zezë, me përbërje (+/- 3%), 70% lesh, 30% poliestër, masa 205 gr/m² (+/-3%). Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë, në të cilin montohet në

pjesën e përparme, në të gjithë gjatësinë e saj, një dekoracion me gjethe lisi të punuar me fije me ngjyrë të artë. Kapela në bashkimin e tepelekut me rrethin, përshkohet nga një fileto e kuqe 3 mm.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej pambuk-poliesteri, i thurur me dy kordonë, me ngjyrë ari, vendoset në krahun e majtë nën spalinë.

Dorezat ceremoniale janë prej materiali pambuku, me ngjyrë të bardhë.

Rripi ceremonial është material sintetik me ngjyrë të artë, mbërthehet me anë të një togëze me të njëjtën ngjyrë, e cila ka të stampuar në qendër shqiponjën e flamurit kombëtar.

Uniforma dimërore përbëhet nga: kostumi (kapelë, xhaketë, pantallona), shirit dekorativ (fjongo), dorëza të bardha, këpucë gjysma të zeza, rrip ceremonial, rrip pantallonash.

Xhaketa do të jetë dopjopet prej stofi leshi dimëror, me ngjyrë të kuqe, me përbërje (+/- 3%), 70% lesh, 30% poliestër, masa 280 gr/m² (+/- 3%). Xhaketa është me jakë të zezë të mbyllur, e cila në anësore përshkohet nga fileto me ngjyrë të kuqe 3 mm. Jaka, në të gjithë gjatësinë e saj, është e qëndisur me fije ngjyrë ari, me gjethe në formë kurore, që fillojnë nga përpara e bashkohen në mesin e jakës prapa. Xhaketa përpara mbyllet me 9 çifte kopsash të mëdha Garde. Xhaketa te supet ka dy spaleta pllake me ngjyrë të artë, në pjesën e përparme të mëngëve është qëndisur me fill të zi, shqiponja, në mesin e së cilës është qëndisur me fill ngjyrë ari, përkrenarja e Skënderbeut.

Pantallonat janë stof leshi dimëror, me ngjyrë të zezë, me përbërje (+/-3%), 70% lesh, 30% poliestër (+/-3%), masa 240 gr/m² (+/-3%). Ka dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse ka dy pensa nga jashtë, në pjesën e prapme djathtas ka një xhep të brendshëm me fileto që mbyllet me kopsë. Pantallonat, në dy anësoret, në bashkimin e përparëseve me pjesën e prapme të tyre, përshkohet nga shiriti i kuq 3 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Kapela është stof leshi dimëror, me ngjyrë të zezë, me përbërje (+/-3%), 70% lesh, 30% poliestër, masa 240 gr/m² (+/- 3%). Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë, në të cilin montohet në pjesën e përparme, në të gjithë gjatësinë e saj një dekoracion me gjethe lisi, të punuar me fije me ngjyrë të artë.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej pambuk-poliesteri i thurur me dy kordonë, me ngjyrë ari, vendoset në krahun e majtë nën spalinë.

Doreza ceremoniale janë prej materiali pambuku, me ngjyrë të bardhë.

Rripi ceremonial është material sintetik me ngjyrë të artë, mbërthehet me anë të një togëze me të njëjtën ngjyrë, e cila ka të stampuar në qendër shqiponjën e flamurit kombëtar.

E. UNIFORMA E SHOQËRIMIT CEREMONIAL ME MOTOÇIKLETË



Kjo uniformë do të jetë verore dhe dimërore.

Uniforma verore përbëhet nga:

Kostumi i uniformës bazë në detyrë (kapelë, xhaketë, pantallona), këmbë me mëngë të gjata, kravatë uniforme, kaskë mbrojtëse motoçiklisti, doreza motoçiklisti, çizme motoçiklisti, rrip krahëqafë ceremonial.

Uniforma dimërore përbëhet nga:

Kostum lëkure (xhakovento, pantallona), kaskë mbrojtëse motoçiklisti, doreza motoçiklisti, çizme motoçiklisti, rrip krahëqafë ceremonial.

Kostumi i lëkurës (xhaketë, pantallona), është 100% lëkurë natyrale shevro keci, cilësi e parë, ngjyrë e zezë.

Doreza lëkure (motoçiklisti) lëkurë natyrale shevro keci, cilësi e parë. Dorezat janë me pesë gishta.

Kaskë mbrojtëse motoçiklisti: kaska me ngjyrë të bardhë është me përbërje polikarbonate. Kaska të jetë me ajrosje. Pjesa e brendshme të jetë e çmontueshme për larje. Mbrojtësja përpara të jetë kundra rrezeve ultraviole.

Rrip krahëqafë ceremonial motoçiklisti: është material lëkure (telatin), cilësi e parë, me ngjyrë të bardhë. Rripi përbëhet nga pjesa kryesore, togëzat me dy kunjë me ngjyrë të artë dhe dy ylyqe lëkure për fiksimin e rripit krahëqafë. Rripi tjetër që kalon krahëqafë është me gjatësi nga 90 ÷ 100 cm dhe gjerësi 2.5 cm.

Çizme motoçiklisti është material lëkure (boks viçi), cilësia e parë. Gomë kompakte. Çizmet janë me përf forcime të kyçit të këmbës dhe kanë qafë të butë që lejojnë futjen e këmbës me lehtësi. Mbyllje me zinxhir dhe velkro.

UNIFORMA CIVILE (konvertohet në vlerë monetare) përbëhet nga:

Palltoja civile, tekstil me ngjyrë të errët, me përbërje ($\pm 3\%$): 75% lesh, 20% poliamide dhe 5% poliestër; masa 480 gr/m² ($\pm 3\%$). Astari 100% poliestër. Dy xhepa me konstruksion të brendshëm me kapak me fileto.

Kostumi civil, tekstil me ngjyrë të errët, me përbërje 100% lesh, me peshë 210 gr/m² ($\pm 3\%$).

Xhaketa, që duhet të pajiset me dy xhepa me konstruksion të brendshëm me kapak me fileto, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Pantallonat, konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat janë me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me dy xhepa të pasmë me

fileto të dyfishtë të pozicionuar menjëherë poshtë pensave.

Këmishë civile me mëngë të gjata, tekstili me ngjyrë të bardhë, me përbërje ($\pm 3\%$) 80 % pambuk 20 % poliestër; masa 120 gr/m² ($\pm 3\%$). Pjesa e majtë e këmishës të jetë e pajisur me bordurë për hapjen e vrimave të kopsave, ndërsa pjesa e djathtë të jetë e pajisur me bordurë për qepjen e 6 kopsave. Jaka e tipit klasik me maja gjysmë të hapura.

Kravata civile, material me përbërje ($\pm 3\%$), 80% poliestër, 20% viskozë; masa 105 gr/m² ($\pm 3\%$); gjatësia 150 cm, gjerësi 7–8 cm.

Lidhja nr. 4

PARAQITJA DHE FORMA E SHENJAVE DALLUESE TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Shenjat dalluese të Gardës së Republikës, janë:

- Shenja e mbiemrit;
- Shenja e kapelës (emblemë);
- Shiriti dhe dekoracioni i strehës së kapelës;
- Shenjat e jakës;
- Shenja e gjoksit;
- Stema e Republikës (shenjë krah);
- Stema e Gardës (shenjë krah);
- Kopsat;

A. SHENJA E MBIEMRIT

Shenja e mbiemrit, është në formë drejtkëndore me përmasa 8.5 cm gjatësi, 3 cm gjerësi. Shenja e mbiemrit në të gjithë perimetrin e saj rrethohet me një kornizë me ngjyrë të kuqe me gjerësi 2 mm. Shenja, në krahun e majtë ka përkrenaren e Skënderbeut, në profil nga e djathta dhe në pjesën tjetër shkruhet me shkronja kapitale, me shkrim “arial” bold, me lartësi 10 mm, me ngjyrë të artë, mbiemri i punonjësit të Gardës. Të gjithë elementet e shenjës së mbiemrit janë ngjyrë ari. Shenja e mbiemrit vendoset mbi kapakun e xhepit të djathtë në gjoks.



B. SHENJA E KAPELËS


(Emblemë e madhe)

Është në ngjyrë të artë. Elementi bazë është Shqiponja e Flamurit, me përkrenaren e Skënderbeut në profil nga e djathta, e vendosur mbi dy kokat e Shqiponjës, e rrethuar me një kurorë gjethe lisi. Emblema vendoset në pjesën ballore të kapelës së kostumit të uniformës bazë në detyrë. Emblema ka përmasa 6.5 cm x 5.5 cm.



(Emblemë e vogël)

Është në ngjyrë të artë. Elementi bazë është Shqiponja e Flamurit, me përkrenaren e Skënderbeut në profil nga e djathta, e vendosur mbi dy kokat e Shqiponjës, e rrethuar me një kurorë gjethe lisi. Emblema vendoset në pjesën ballore të kapelës së kostumit të shërbimit e stërvitjes. Emblema ka përmasa 4.5 cm x 3.5 cm.



C. SHIRITAT DHE DEKORACIONI I STREHËS SË KAPELËS

Shiriti i kapelës (kordoni) është me përbërje 70% sintetik dhe 30% pambuk. Shiriti në të dy ekstremet montohet me kopsa tip vidhe. Për uniformën e gradës “Drejtues madhor” është një kordon dysh i thurur, ngjyrë ari, në të dy anët e secilit vendoset nga një kordon tek, i thurur, ngjyrë ari. Në uniformën e trupprojës së nderit dhe për gradat “Drejtues”, “Drejtues i parë” e “Drejtues i lartë” është vetëm një kordon dysh i thurur ngjyrë ari.

Për gradat e nivelit të mesëm, shiriti i kapelës është material plastik me metalizim, me ngjyrë ari, ku është e punuar në relief një degëzim gjethe lisi.

Për gradat e nivelit bazë, shiriti i kapelës është i njëjtë me atë të gradave të nivelit të mesëm, por pa punim të gjethtës.

Dekoracioni i strehës së kapelës, elemente bazë janë dekoracioni kurorë, gjethe lisi në formë harkore sipas strehës së kapelës. Të gjitha elementet e dekoracionit të kapelës janë të

qëndisura me fije ngjyrë ari. Dekoracioni kurorë mbështetet në të gjithë gjerësinë e strehës së kapelës. Gjerësia e dekoracionit në anë 1 cm, duke u zgjeruar në qendër 2 cm.

Për gradën “Drejtues madhor” ka dy elemente kurorë, kurse për gradën “Drejtues i lartë” gradat e nivelit të lartë dhe uniformën e trupprojës së nderit, ka një element kurorë.

DEKORACION STREHË KAPELE
DREJTUES MADHOR



DEKORACION STREHË KAPELE
DREJTUES I LARTË, DREJTUESI PARË, DREJTUES



STREHË KAPELE NIVELI I MESËM, NIVELI BAZË



SHIRIT (KORDON) KAPELE
DREJTUES MADHOR



SHIRIT (KORDON) KAPELE
DREJTUES I LARTË, DREJTUESI PARË, DREJTUES



SHIRIT KAPELE NIVELI I MESËM



SHIRIT KAPELE NIVELI BAZË



(Për nivelin madhor, të lartë, të mesëm)




D. SHENJAT E JAKËS

Shenja e jakës së sipërme, elementet bazë janë: dy kurora me gjethe lisi, të bashkuara në pjesën e poshtme, ndërsa në pjesën e sipërme, largësia mes kurorave është 5 cm, lartësia 3.5 cm. Në mes të kurorave vendosën përkrenaret e Skënderbeut, me dimensione 2.5 x 1.7 cm, në profil, që shikojnë nga njëra-tjetra. Ato vendosen në dy anët e jakës së sipërme të xhakëtës, sipas vijës së qepjes së jakave. Të gjithë elementet e shenjës së jakës janë me ngjyrë ari.

Shenja e jakës së poshtme është me përmasa 2 cm gjerësi, 1.3 cm lartësi. Elementi bazë është kalaja e stilizuar me një beden, me përmasa 2 cm x 0.5 cm, mbi të cilën vendosën dy shpata të kryqëzuara me përmasa 0.5 cm x 0.4 cm. Shenja në pjesën e poshtme është në formë gjysmë rrethore ku shkruhet “GARDA E REPUBLIKËS”. Shenja


është e punuar me material ngjyrë ari. Vendoset në të dy anët e jakës së poshtme të xhaketës.

(Për nivelin madhor & të lartë)



E. SHENJË GJOKSI

Shenja e gjoksit është ngjyrë ari, dhe me përmasa 8.5 cm gjatësi, 2 cm gjerësi për gradat e nivelit të lartë; 8.5 cm gjatësi, 2.4 cm gjerësi për gradat e nivelit madhor. Elementi bazë është një kështjellë e stilizuar me bedena të shkallëzuara, me dy shpata të kryqëzuara në qendër. Ka gjashtë rreshta (4 mm secili) për gradat e nivelit madhor dhe pesë rreshta (4 mm secili) për gradat e nivelit të lartë. Në pjesën e pasme stema ka të montuar me perçina një kapëse sustë për fiksimin në mënyrë të palëvizshme të saj në xhaketë. Material.



F. STEMA E REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Material tekstil i qëndisur me penj sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës. Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7.5 x 6 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe, në mes të së cilës gjendet shqiponja dykrenare me ngjyrë të zezë, mbi të cilën në qendër vendoset përkrenarja e Skënderbeut, ngjyrë ari, me profil nga e djathta. Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë të artë, me gjerësi 2 mm. Stema vendoset në krahun e majtë të uniformës.



G. STEMA E GARDËS SË REPUBLIKËS (Shenjë krah)

Material tekstil i qëndisur me penj sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës. Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7.5 cm x 6 cm +/- 0.1 cm. Stema është në formën e një mburoje (shqyti), pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale.

Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari me gjerësi 2 mm. Në brendësi vendoset shqiponja dykrenare, me ngjyrë të zezë. Mbi shqiponjë qëndron përkrenarja e heroit kombëtar, Skënderbeut, në ngjyrë të artë. Në fund të shqytit është shkruar me germa kapitale "GARDA E REPUBLIKËS". Stema vendoset në krahun e djathtë të uniformës.



H. KOPSAT E MËDHA DHE TË VOGLA

Janë me ngjyrë të artë për të gjitha llojet e gradave. Kopsat në qendër të tyre kanë të stampuar në relief shenjën dalluese, përkrenaren e Skënderbeut, në profil, me pamje nga e djathta, ku shkruhet në mënyrë gjysmërrethore me shkronja kapitale "GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË".



E madhe Ø 22 mm



E vogël Ø 1,4 mm



Lidhja nr. 5

**NORMAT E FURNIZIMIT ME VESHMBATHJE
TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS**

- A. Norma e furnizimit me uniformë Garde, për punonjësit e nivelit të mesëm, të lartë, madhor.
 B. Norma e furnizimit me uniformë Garde, për punonjësit e nivelit bazë.
 C. Norma e furnizimit me veshje civile.
 D. Norma e furnizimit me materiale inventar të strukturave të Gardës së Republikës.
 E. Norma e furnizimit me materiale konsumi e mirëmbajtje për punonjësit e Gardës së Republikës.

**A. Norma e furnizimit me uniformë Garde, për punonjësit e nivelit të mesëm,
të lartë, madhor**

Nr.	Emërtimi i objektit të uniformës	Njësia	Sasia	Afati/vite
A	Uniforma bazë në detyrë			
1	Xhup 3/4 me veshje të ngrohtë			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	1	2
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	1	4
2	Xhakovento uniforme			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	1	2
3	Kostum uniforme (kapelë, xhaketë, pantallona)			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	kompl	1	3
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	kompl	1	2
4	Këmishë me mëngë të gjata			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	3	3
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	3	2
5	Kravatë uniforme			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	1	3
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	1	2
6	Pulovër uniforme	copë	1	3
7	Shall	copë	1	3
8	Rrip pantallonash	copë	1	3
9	Këpucë gjysma uniforme			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	palë	1	2
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	palë	1	1
10	Çorape	palë	4	1
B	Uniforma dimërore			
1	Pelerinë shiu	copë	1	6
2	Bluzë e brendshme pambuku m/gjata			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	3	2
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	3	4
3	Këpucë me qafa dimërore			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	palë	1	4



	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	palë	1	2
4	Doreza lëkure	palë	1	6
C	Uniforma verore			
1	Këmishë me mëngë të shkurtra			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	3	4
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	3	2
2	Bluzë me mëngë shkurtra (me tri kopsa)			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	3	2
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	3	6
3	Bluzë e brendshme pambuku m/shkurtra (jakë rrethore)			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	3	2
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	3	6
4	Pantallona vere	palë	2	2
D	Uniforma për shërbim e stërvitje			
1	Kostum shërbimi e stërvitjeje (kapelë, beretë, xhaketë, pantallona)			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	kompl	1	1
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	kompl	1	3
2	Këpucë me qafa shërbimi e stërvitjeje			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	palë	1	1
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	palë	1	3
3	Jelek multifunksional	copë	1	8
4	Rrip mesi			
	Punonjës të nivelit të mesëm në strukturat operuese	copë	1	3
	Punonjës të tjerë të nivelit të mesëm, të lartë e madhor	copë	1	6
E	Uniforma civile dhe sportive			
1	Kostum civil	kompl	1	2
2	Këmishë civile	copë	2	2
3	Kostum sporti	palë	1	4
4	Atlete	palë	1	4

Për punonjëset femra, në vend të një palë pantallonave të kostumit të uniformës, mund të jepet fund për femra, me të njëjtën afat përdorimi.

B. Norma e furnizimit me uniformë Garde, për punonjësit e nivelit bazë

Nr.	Emërtimi i objektit të uniformës	Njësia	Sasia	Afati/vite
A	Uniforma bazë në detyrë			
1	Xhup 3/4 me veshje të ngrohtë			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	1	2
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	1	4
2	Kostum uniforme (kapelë, xhaketë, pantallona)			
	Punonjës trupë shërbimi	kompl	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	kompl	1	3
3	Këmishë me mëngë të gjata			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	3	4



	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	3	3
4	Kravatë uniforme			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	1	3
5	Pulovër uniforme	copë	1	3
6	Shall	copë	1	3
7	Rrip pantallonash			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	1	3
8	Këpucë gjysma uniforme			
	Punonjës trupë shërbimi	palë	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	palë	1	1
9	Çorape	palë	4	1
B	Uniforma dimërore			
1	Pelerinë shiu	copë	1	4
2	Bluzë e brendshme pambuku m/gjata			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	3	2
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	3	4
3	Këpucë me qafa dimërore			
	Punonjës trupë shërbimi	palë	1	4
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	palë	1	2
4	Doreza lëkure	palë	1	6
C	Uniforma verore			
1	Këmishë me mëngë të shkurtra.			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	3	6
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	3	2
2	Bluzë me mëngë shkurtra (me tri kopsa)			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	3	1
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	3	4
3	Bluzë e brendshme pambuku m/shkurtra (jakë rrethore)			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	3	2
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	3	6
4	Pantallona vere	palë	2	2
D	Uniforma për shërbim e stërvitje			
1	Kostum shërbimi e stërvitjeje (kapelë, xhaketë, pantallona)			
	Punonjës trupë shërbimi	kompl	1	8 muaj
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	kompl	1	2
2	Këpucë me qafa shërbimi e stërvitjeje			
	Punonjës trupë shërbimi	palë	1	8 muaj
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	palë	1	2
3	Jelek multifunksional	copë	1	8
4	Rrip mesi			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	1	3
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	1	6



E	Uniforma civile dhe sportive			
1	Kostum civil			
	Punonjës trupë shërbimi	kompl	1	3
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	kompl	1	2
2	Këmishë civile			
	Punonjës trupë shërbimi	copë	2	3
	Punonjës të tjerë të nivelit bazë	copë	2	2
3	Kostum sporti	palë	1	4
4	Atlete	palë	1	4

Për punonjëset femra, në vend të një palë pantallonave të kostumit të uniformës, mund të jepet fund për femra, me të njëjtin afat përdorimi.

C. Norma e furnizimit me veshje civile

Nr.	Emërtimi i objektit të uniformës	Njësia	Sasia	Afati/vite
A	Uniforma bazë në detyrë			
1	Pallto civile	copë	1	3
2	Kostum civil	palë	1	1.5
3	Këmishë civile	copë	2	1
4	Këpucë civile	palë	1	8 muaj
5	Kravatë civile	copë	1	1.5
6	Doreza lëkure	palë	1	6
7	Çorape	palë	4	1
B	Uniformë oficeri e nënoficeri			
1	Xhup 3/4 me veshje të ngrohtë	copë	1	9
2	Pelerinë shiu	copë	1	9
3	Kostum uniforme (kapelë, xhaketë, palë pantallona)	kompl	1	6
4	Këmishë me mëngë të gjata	copë	2	6
5	Këmishë me mëngë të shkurta	copë	2	6
6	Kravatë uniforme	copë	1	6
7	Këpucë gjysma uniforme	palë	1	6
8	Rrip pantallonash	copë	1	9
C	Uniformë për shërbim e stërvitje			
1	Kostum shërbimi e stërvitjeje (kapelë, xhaketë, pantallona)	kompl	1	6
2	Bluzë me mëngë shkurtra (me tri kopsa)	copë	2	6
3	Bluzë e brendshme pambuku m/gjata (jakë rrethore)	copë	2	6
4	Bluzë e brendshme pambuku m/shkurtra (jakë rrethore)	copë	2	6
5	Shall	copë	1	6
6	Rrip mesi	copë	1	9
7	Jelek multifunksional	copë	1	9
8	Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje	palë	1	6
D	Uniformë vere dhe sportive			
1	Jelek	copë	1	4
2	Kostum sporti	palë	1	4
3	Atlete	palë	1	4

Shënim: Gradat dhe Shenjat dalluese jepen sipas llojit të uniformave dhe me të njëjtin afat përdorimi.



D. Norma e furnizimit me materiale inventar të strukturave të Gardës së Republikës

Nr.	Emërtimi	Njësi	Sasi	Afati (në vite)
I	Për punonjësit e të gjithë niveleve			
1	Çantë shpinë	copë	1	Pa afat
2	Gavetë	copë	1	Pa afat
3	Pagurë	copë	1	Pa afat
4	Helmetë	copë	1	Pa afat
5	Çadra të ndryshme (për çdo sektor e shtab strukture)	copë	1	Pa afat
II	Për Truprojën e Nderit			
1	Kostum ceremonial vere (kapelë, xhakëtë, pantallona, fjongo)	kompl	1	2
2	Kostum ceremonial dimri (kapelë, xhakëtë, pantallona, fjongo)	kompl	1	4
3	Këpucë gjysma	palë	1	8 muaj
4	Doreza të bardha ceremoniali	palë	4	1
5	Bluza pambuku me mëngë të shkurta	copë	2	1
6	Bluza pambuku me mëngë të gjata	copë	2	2
7	Rrip mesi ceremoniali	copë	1	4
III	Për efektivin e Njësisë Speciale			
1	Xhup operacional	copë	1	4
2	Kostum taktik operacional (kapelë, xhakëtë, pantallona)	kompl	1	4
3	Kominoshe taktike	palë	1	4
4	Këpucë taktike me qafa	palë	1	4
5	Maskë (kapuç) operacionale	copë	1	4
IV	Për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial			
1	Kostum dimëror (xhup, pantallona, kapelë sporti) policia rrugore	kompl	1	4
2	Pantallona doku ripstop + kapelë (policia rrugore)	palë	3	2
3	Bluzë pambuku me 3 kopsa, me mëngë të shkurtra (policia rrugore)	copë	3	2
5	Pelerinë shiu (policia rrugore)	copë	1	6
6	Kostum dimëror ceremonial (xhakëtë, pantallona) motoçiklisti (vetëm motoçiklistët)	kompl	1	4
7	Kostum veror ceremonial (xhakëtë, pantallona, kapelë) motoçiklisti (vetëm motoçiklistët)	kompl	1	3
8	Këmishë me mëngë të gjata (vetëm motoçiklistët)	copë	2	3
9	Kravatë uniforme (vetëm motoçiklistët)	copë	1	3
10	Kaskë mbrojtëse motoçiklisti (vetëm motoçiklistët)	copë	1	5
11	Doreza lëkure motoçiklisti (vetëm motoçiklistët)	palë	1	4
12	Syze mbrojtëse (vetëm motoçiklistët)	copë	1	5
13	Çizme lëkure (vetëm motoçiklistët)	palë	1	4
14	Rrip krahëqafë i bardhë (vetëm motoçiklistët)	copë	1	4
V	Për punonjësit trupë shërbimi me veshje uniforme			
1	Kapuç leshi	copë	1	2
VI	Për mjek, infermier, laborant, sanitar			
1	Bluzë e bardhë	copë	1	2
2	Peshqir	copë	2	1
VII	Për teknikët e ndërlidhjes, xhenios, kimisë, armatimit			
1	Kostum pune (xhakëtë, pantallona) ose kominoshe	palë	1	2



2	Doreza doku gomuara	palë	1	2
3	Peshqir	copë	2	1
VIII	Për instruktorët e qenve			
1	Kominoshe	palë	1	2
2	Çizme gome	palë	1	1
3	Peshqir	copë	2	1
IX	Për punonjësit e riparimit të automjeteve			
1	Kostum pune (xhakëtë, pantallona) ose kominoshe	palë	1	2
2	Këpucë pune	palë	1	2
3	Doreza doku gomuara	palë	1	1
4	Peshqir	copë	2	1
X	Për punonjësit civile të mirëmbajtjes së infrastrukturës			
1	Kostum pune (xhakëtë, pantallona) ose kominoshe	palë	1	2
2	Këpucë pune	palë	1	2
3	Kaskë mbrojtëse	copë	1	pa afat
4	Rrip sigurie	copë	1	pa afat
5	Jelek fosforeshent	copë	1	2
6	Doreza doku gomuara	palë	1	1
XI	Për përgjegjësit material (magazininierët)			
1	Bluzë doku	palë	1	2
2	Peshqir	copë	2	1
XII	Materialet e fjetjes			
1	Batanije	copë	2	6
2	Dyshek	copë	1	6
3	Jastëk	copë	1	6
4	Çarçafë	copë	4	4
5	Këllëf jastëku	copë	2	4
XIII	Pajisjet dhe materialet e pastrimit për qen shërbimi			
1	Hallkë metalike	copë	1	1
2	Hundëze	copë	2	1
3	Qafore lëkure	copë	2	1
4	Qafore zinxhir	copë	1	1
5	Gjoksore	copë	1	1
6	Kostum figurant	copë	1	3
7	Krehër metalik	copë	2	2
8	Litar najloni	ml	20	1
9	Aport top tenisi	copë	2	1
10	Aport top gome	copë	2	1
11	Aport peshqiri	copë	4	1
12	Qafore antiparazitare	copë	2	1

Artikujt e mësipërm janë materiale inventar në strukturat e Gardës, ato ruhen dhe administrohen sipas afateve të përdorimit.

Uniforma për efektivin shofer (makinë policie) dhe motoçiklist ceremonial, është e njëjtë me atë të Policisë së Shtetit (Policia Rrugore), me gradat e shenjat dalluese të Gardës së Republikës.



**E. Norma e furnizimit me materiale konsumi e mirëmbajtjeje për punonjësit
e Gardës së Republikës**

Nr.	Emërtimi	Njësia matjes	Në vit	Në muaj
I	Për Truprojën e Nderit			
a	Bojë këpucësh (për person)	gr	-	100
b	Furçë këpucësh (për çdo 10 veta)	copë	2	-
c	Furçë rrobash (për çdo 10 veta)	copë	1	-
d	Hekur hekurosjeje (për çdo 10 veta)	copë	1	-
II	Për larjen e teshave me makinë larëse			
a	Detergjent larës, për çdo kg tesha		30 gr	
III	Për profesionet e ndryshme			
a	Për çdo punonjës të shërbimit shëndetësor dhe sanitar			
	Sapun tualeti	gr	-	200
b	Për çdo punonjës në shërbimin e mirëmbajtjes së automjeteve			
	Sapun tualeti	gr	-	200
c	Për çdo punonjës laborant; teknik IT, kimie, xhenio, armatimi			
	Sapun tualeti	gr	-	200
d	Për çdo punonjës instruktor qeni			
	Sapun tualeti	gr	-	200
IV	Për larjen e mirëmbajtjen e qenit antiexploziv			
	Shampo	litër	-	2
	Furçë për pastrim trupi	copë	2	-
V	Për mirëmbajtjen e veshmbathjes në magazinë			
	Naftalinë, për çdo depo	kg	2	-

VENDIM

Nr. 654, datë 3.11.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 2, TË KONTRATËS
FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR
PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË *BYPASS*-
it TË FIERIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 80/2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2, të kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin e ndërtimit të *bypass*-it të Fierit, ratifikuar me ligjin nr. 80/2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Numri i kontratës FI N° 31.045 (AL)
Numri Operacional Serapis N° 2007-0204
Niveli i Klasifikimit të Brendshëm të BEI-t:
Për përdorim korporate

BYPASS-i I FIERIT

MARRËVESHJE AMENDIMI NR. 2, NË LIDHJE ME KONTRATËN FINANCIARE TË NËNSHKRUAR MË 11 QERSHOR 2012, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE

Tiranë, 31 gusht 2021
Luksemburg, 13 gusht 2021

KJO MARRËVESHJE AMENDIMI LIDHET NDËRMJET

Republikës së Shqipërisë nga njëra anë
("Huamarrësi") dhe

Bankës Evropiane të Investimeve, me seli në
adresën: 100 Boulevard Konrad Adenauer,
L-2950-Luksemburg, përfaqësuar nga
("Banka"), nga ana tjetër; së bashku të referuara si
"Palët".

INFORMACION PARAPRAK

A. Palët nënshkruan këtë kontratë financiare më
11 qershor 2012, e cila më pas u ndryshua si
(**Kontrata Financiare**);

B. Në vijim të kërkesës së datës 8 mars 2021, të
marrë nga Huamarrësi, Palët kanë rënë dakord të
lidhin këtë Marrëveshje Amendimi (në vijim e
referuar si **Marrëveshje Amendimi**) për të
ndryshuar disa kushte të Kontratës Financiare;

U RA DAKORD SI VIJON:

1. INTERPRETIMI

Me përjashtim të rasteve kur haset një tregues i
kundërt, termat me germa të mëdha, të përcaktuara
në Kontratën Financiare, do të kenë të njëjtin
kuptim edhe kur të përdoren në këtë Marrëveshje
Amendimi.

2. NDRYSHIMET

Duke nisur nga Data e Hyrjes në Fuqi, Kontrata
Financiare do të ndryshohet si më poshtë.

Paragrafi i përkufizimeve

Në listën e përkufizimeve, përkufizimi "Data
Përfundimtare e Vlefshmërisë" do të ndryshohet sa
më poshtë:

“Data përfundimtare e Vlefshmërisë”
nënkupton datën 31 dhjetor 2021.”.

Skedulet

A. **Skeduli A.1** (Përshkrimi Teknik (neni 6.02)),
paragrafi "Kalendari" do të ndryshohet si vijon:

"Kalendari"

Ndërtimi i projektit pritet të fillojë në tremujorin
e parë të vitit 2021, me përfundimin e tremujorit të
tretë të vitit 2021.”.

B. Skeduli a B (Përkufizimi i EURIBOR-it) do
të zëvendësohet me skedulën B (Përkufizimi i
EURIBOR-it) bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje
Amendimi si aneksi A.

3. PËRFAQËSIMI

Përfaqësimet dhe garancitë që përsëriten, sipas
dhe në përputhje me nenin 6.07 (Përfaqësimet dhe
Garancitë e përgjithshme), të Kontratës Financiare,
do të konsiderohen të përsëritura (duke iu referuar
fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë kohë)
nga Huamarrësi: i. në datën kur Huamarrësi
nënshkruan këtë Marrëveshje Amendimi; dhe ii. në
Datën e Hyrjes në Fuqi.

4. TË NDRYSHME

4.1 Përveç përputhjes me nenin 2 (Ndryshimet),
të kësaj Marrëveshjeje Amendimi, asnjë dispozitë e
kësaj Marrëveshjeje Amendimi nuk do të kufizojë,
limitojë apo në ndonjë mënyrë tjetër, të ndryshojë
të drejtat e Bankës sipas Kontratës Financiare.

4.2 Kjo Marrëveshje Amendimi nuk është (dhe
nuk do të konsiderohet se është) një pëlqim,
marrëveshje, ndryshim apo heqje dorë në lidhje me
afatet, dispozitat ose kushtet e Kontratës
Financiare, me përjashtim të rasteve kur është rënë
dakord shprehimisht në këtë marrëveshje. Banka
rezervon çdo të drejtë tjetër ose masë korrigjuese
që mund të ketë tani ose më pas.

4.3 Termat dhe kushtet në Kontratën Financiare
konfirmohen në këtë Marrëveshje, do të qëndrojnë
në fuqi dhe do të kenë efekt dhe termat e
Marrëveshjes së Amendimit, do të interpretohen
dhe shpjegohen saktësisht pa cenuar të drejtat dhe
kompetencat e Bankës sipas Kontratës Financiare,
përfshirë të gjitha të drejtat dhe masat korrigjuese,
në lidhje me çdo mospërputhje tjetër, e cila: i. nuk i
është bërë me dije Bankës përpara Datës së Hyrjes
në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi; ii.
vazhdon dhe prej së cilës nuk është hequr dorë
para Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje
Amendimi nga Banka; ose iii. lind në ose pas Datës



së Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi.

4.4 Banka e lëshon këtë Marrëveshje Amendimi duke u mbështetur në informacionin që Huamarrësi i ka vënë në dispozicion Bankës deri në Ditën e Hyrjes në Fuqi të marrëveshjes, në lidhje me faktin që këto çështje të jenë të vërteta, të plota dhe të sakta. Kjo nuk duhet të cenojë të drejtat që Banka mund të zotërojë në çdo kohë, në lidhje me rrethana apo çështje të tjera, me përjashtim të rasteve që janë referuar në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje Amendimi, ose në lidhje me informacionet që nuk janë të vërteta, të plota dhe të sakta, të drejtat e Bankës do të jenë në fuqi dhe efekt të plotë.

4.5 Huamarrësi, me kërkesë të Bankës dhe me shpenzimet e tij, do të kryejë të gjitha veprimet dhe çdo gjë të nevojshme ose të përshtatshme për t'u dhënë fuqi ndryshimeve që janë kryer ose do të kryhen në përputhje me Marrëveshjen e Amendimit.

4.6 Neni 11.01 (Ligji Rregullues), neni 11.02 (Juridiksioni), neni 12.01 (Forma e Njoftimit) dhe neni 12.02 (Adresat për Njoftimet) të Kontratës Financiare do të përdoren *mutatis mutandis* edhe në këtë Marrëveshje Amendimi.

4.7 Kjo Marrëveshje Amendimi dhe të gjitha çështjet, qoftë kontraktuale ose jo, që rrjedhin nga ose në lidhje me të, do të rregullohen nga dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin e Dukatit të Madh të Luksemburgut, dhe të gjitha mosmarrëveshjet që lidhen me të do të dorëzohen pranë juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

5. DATA E HYRJES NË FUQI

Kjo Marrëveshje Amendimi do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt menjëherë pasi Banka t'i konfirmojë Huamarrësit që ka marrë komunikimin me shkrim të Huamarrësit në lidhje me përfundimin e procedurave të tij të brendshme ("Data e Hyrjes në Fuqi").

Nga Data e Hyrjes në Fuqi, referimet në Kontratën Financiare të "kjo Kontratë" dhe referime të tjera të ngjashme do të lexohen dhe interpretohen si referime të Kontratës Financiare të ndryshuar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi.

Kjo Marrëveshje Amendimi është hartuar në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe secila

faqe është sigluar në emër të Huamarrësit dhe në emër të Bankës.

Në Tiranë, më 31.8.2021

Nënshkruar për dhe në emër të
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Anila Denaj

Në Luksemburg, më 13 gusht 2021

Nënshkruar për dhe në emër të
BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE
Drejtori i Divizionit Analisti i Kredisë
Monika Mroczek - Comparetto
Victor Dominiak

Aneksi A i Marrëveshjes së Amendimit

Skeduli B

Përkufizimi i EURIBOR-it

A. EURIBOR

EURIBOR nënkupton:

a) Në lidhje me një periudhë përkatëse prej jo më pak se një muaj, Norma e Interesit (siç përcaktohet më poshtë) për një periudhë prej një muaj;

b) Në lidhje me një periudhë përkatëse të një apo më shumë muajsh të plotë, për të cilën është e disponueshme një Normë Interesi, norma e interesit për një periudhë të numrave korrespondues të muajve; dhe

c) Në lidhje me një periudhë përkatëse prej më shumë se një muaji për të cilën nuk është e disponueshme një Normë Interesi, norma që rezulton nga një interpolim linear me referencë ndaj dy normave për depozitat në Euro, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të mëpasshme të shkurtër dhe për një periudhë tjetër më të gjatë sesa gjatësia e periudhës përkatëse,

(periudha për të cilën norma është marrë ose nga të cilat normat janë interpeluar, referohet si "Periudha përfaqësuese").

Për qëllime të paragrafëve (b) dhe (c), më sipër:

i. "**të disponueshme**" nënkupton normat, për maturimet e dhëna, të cilat janë llogaritur dhe publikohen nga *Global Rate Set Systems Ltd* (GRSS), ose një ofrues i tillë i shërbimeve, të përzgjedhura



nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parave (EMMI), nën sponsorizimin e EMMI-t dhe EURIBOR ACI, ose çdo pasues i atij funksioni të EMMI-t dhe EURIBOR ACI, siç përcaktohet nga Banka; dhe **“Normë Interesi”** nënkupton normën e interesit për depozitat në Euro për periudhën përkatëse, siç është publikuar në orën 11:00, ora e Brukselit apo në një orë të mëvonshme, të pranueshme për Bankën në atë ditë (**“Data e Rivendosur”**), e cila bie 2 (dy) Ditë Përkatëse Pune para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen e Reuters EURIBOR 01 ose në faqen e pasuesit të saj ose, në mungesë të së cilës, me çdo mjet tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Në rast se Norma e Interesit nuk publikohet, Banka do t'u kërkojë zyrtarëve qendrorë të katër bankave kryesore të euro-zonës, të përzgjedhura nga Banka, që të kuotojnë normën e ofruar prej tyre për depozitat në EURO në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11:00, me orën e Brukselit, në Ditën e Ndryshimit të Normës, për t'i informuar bankat në tregun ndërbankar të euro-zonës për një periudhë të barabartë me Periudhën Përfaqësuese. Në rast se nuk ofrohen kuotimet e përshtatshme sipas kërkesës, norma për Datën e Ndryshimit të Normës do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuara nga bankat kryesore të euro-zonës, të përzgjedhura nga vetë Banka, rreth orës 11:00, me orën e Brukselit, në ditën që bie 2 (dy) Ditë Pune Përkatëse pas Ditës së Ndryshimit të Normës, për huatë në EURO me një shumë të krahasueshme në bankat kryesore evropiane, për një periudhë të barabartë me Periudhën Përfaqësuese. Banka do të informojë pa vonesë Huamarrësin, në lidhje me kuotimet e marra prej saj.

Të gjitha përqindjet që përfshihen nga përlllogaritjet e referuara në këtë skedul do të rrumbullakosen, nëse do të jetë e nevojshme, me një të mijtën më të afërt të përqindjes, ndërkohë që edhe shifrat që janë të përgjysmuara do të rrumbullakosen.

Në rast se ndonjë nga dispozitat e mësipërme bie ndesh me dispozitat e miratuara me mbështetjen e EMMI-t (ose të cilitdo pasardhës që ushtron funksionin e EMMI-t, siç përcaktohet nga Banka) në lidhje me EURIBOR-in, Banka, duke vënë në dijeni Huamarrësin, mund ta ndryshojë

dispozitën në mënyrë që ajo të jetë në përputhje me dispozitat e tjera.

Në rast se Norma e Interesit nuk është më e vlefshme, norma zëvendësuese e EURIBOR-it do të jetë norma (duke përfshirë të gjitha marzhet apo rregullimet) e rekomanduar në mënyrë formale nga: i. grupi i punës për normat Euro pa rrezik të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane (ECB), Autoriteti i Shërbimeve Financiare dhe Tregjeve (FSMA), Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA) dhe Komisioni Evropian; ose ii. Instituti Evropian i Tregut Monetar si administrator i EURIBOR-it; ose iii. autoriteti përkatës përgjegjës sipas Rregullores (EU) 2016/1011 për mbikëqyrjen e Institutit Evropian të Tregut Monetar, si administrator i EURIBOR-it; ose iv. autoritetet përkatëse kombëtare të përcaktuara sipas rregullores (EU) 2016/1011; ose v. Banka Qendrore Evropiane.

Në rast se asnjë Normë Interesi dhe/ose normë zëvendësuese për EURIBOR-in nuk është e vlefshme, siç parashikohet më sipër, EURIBOR-i do të jetë norma (e shprehur në përqindje për çdo vit), e cila përcaktohet nga Banka si kosto gjithëpërfshirëse për Bankën, në mënyrë që të financohet Transhi përkatës bazuar në normën e interesit të gjeneruar asokohe brenda Bankës ose në metodën e përcaktimit të normës alternative të vendosur nga Banka.

VENDIM

Nr. 661, datë 3.11.2021

PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË QENDRAVE/INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE, PUBLIKE APO PRIVATE, SI DHE TË KRITEREVE QË ATO DUHET TË PLOTËSOJNË PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Institucionet e arsimit të lartë (IAL) në fushën e shëndetësisë lidhin marrëveshje, për të gjitha ciklet e studimit, me qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, publike apo private, të licencuara dhe të akredituara, sipas llojit e që plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë vendim.

2. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, me të cilat lidhen marrëveshje, janë të llojeve të mëposhtme:

a) spitale rajonale dhe terciare;

b) struktura spitalore që ofrojnë shërbime shëndetësore, sipas përcaktimeve të bëra nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

c) struktura ambulatorie të specializuara.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton kapacitetet pritëse të qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, përpara se ata të lidhin marrëveshje me IAL-et, sipas standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

4. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, me përjashtim të qendrave spitalore universitare, mund të lidhin marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë, për qëllime mësimore dhe kërkimore-shkencore. Për ndjekjen e praktikave mësimore dhe kërkimore-shkencore pranë qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, me përjashtim të qendrave spitalore universitare, IAL-i i paguan qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor tarifën përkatëse, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës të financave. Të ardhurat e përfituara nga këto tarifa konsiderohen të ardhura dytësore për qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor.

5. Mënyra e ndjekjes së praktikave mësimore dhe kërkimore-shkencore, sipas cikleve të studimit, përcaktohet në marrëveshjen që do të lidhin qendra/institucioni i kujdesit shëndetësor dhe institucioni i arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë.

6. Qendra/institucioni i kujdesit shëndetësor, i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) objekti, për të cilin është ngritur e funksionon, përfshin edhe objektin e marrëveshjes së propozuar për nënshkrim;

b) të jetë licencuar dhe akredituar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor;

c) të ketë normativë të shfrytëzimit të kapacitetit të qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor mbi 60 (gjashtëdhjetë) %;

ç) të ketë personel mjekësor, me kualifikimet e nevojshme akademike e profesionale, sipas kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi;

d) të ketë kapacitetet profesional në funksion të plotësimit të kërkesave për një mësim, sipas standardit të përcaktuar. Procedurat praktike të jenë sipas standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;

dh) të plotësojë kushtet infrastrukturore, teknologjike dhe fizike, sipas natyrës së institucionit e të shërbimeve që ofron;

e) të ketë strukturë organizative me kapacitetet e nevojshme profesionale, si dhe kapacitetet organizative, për të pritur numrin e praktikantëve, bazuar në marrëveshjet e lidhura ndërmjet IAL-eve dhe qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi;

ë) të respektojë kapacitetin pritës të institucionit dhe të qendrës shëndetësore, duke mos cenuar veprimtarinë normale të qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor dhe plotësimin e nevojave të institucionit të arsimit të lartë për qëllime mësimore cilësore, brenda kohës së punës, përcaktuar në Kodin e Punës.

7. Staf i akademik që drejton studentët nuk ofron kujdes shëndetësor në këto struktura shëndetësore, përveç rasteve kur është pjesë e stafit të institucionit.

8. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë publikon listën e qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, që mund të lidhin marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë, sipas natyrës së shërbimeve shëndetësore që ofrojnë qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor.

9. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, për çdo marrëveshje të lidhur, njoftojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, ndërsa institucionet e arsimit të lartë



njoftojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve ministrinë përgjegjëse për arsimin.

10. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve, sipas marrëveshjes së nënshkruar. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet nga gjykata kompetente.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, si dhe institucionet përkatëse të arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 662, datë 3.11.2021

PËR KRITERET E HARTIMIT TË PLANEVE TË MENAXHIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E EKOSISTEMEVE, HABITATEVE E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR ME STATUS MBROJTJEJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Planet e menaxhimit të ekosistemeve dhe të habitateve me status mbrojtjeje, të cilat ndodhen brenda territorit administrativ të njërive të vetëqeverisjes vendore, hartohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u mbështetur në kriteret e mëposhtme:

a) të përshkruhet territori i ekosistemeve dhe i habitateve si një kompleks dinamik, duke përfshirë bimësinë, kafshët e mikroorganizmat, pyjet, kullotat, ligatinat, sipërfaqet ujore dhe bregdetare, vlerat e kërcënimit e tyre, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale;

b) të përshkruhen veprimtaritë ekonomike që janë kërcënuese për zonën;

c) të parashikohen masa rregullatore ose administrative të nevojshme për të shmangur ose për të pakësuar kërcënimet e identifikuara në ekosistem;

ç) të parashikohen masat për menaxhimin e habitatit, të ekosistemeve, objektivat e menaxhimit, masat e veprimet e menaxhimit, programet e monitorimit, inventarizimit dhe kërkimit shkencor brenda habitateve dhe ekosistemeve;

d) të ketë afat zbatimi 10-vjeçar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, komuniteti lokal, si dhe subjektet që ushtrojnë veprimtaritë e miratuara në territorin përkatës, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2009, “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, të ndryshuar.

2. Ekosistemet dhe habitatet propozohen për t’u shpallur me status mbrojtjeje, nëse territori plotëson, të paktën, njërin prej kriterëve të mëposhtme:

a) të ketë diversitet të llojeve me status mbrojtjeje;

b) të ketë dendësi të ulët të llojeve;

c) të ketë vlera shkencore dhe edukative;

ç) të përfaqësohet si bioqendra dhe biokorridor me rëndësi rajonale e vendore;

d) të ketë rrezikshmëri të lartë, të cilat janë kërcënuar nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, deri në tjetërsimin e habitateve dhe të ekosistemeve;

dh) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër;

e) të përdoret nga llojet shtegtare;

f) të ketë minimumin kritik të madhësisë së habitatit e të ekosistemit.

3. Kriteret për përcaktimin e popullatave të faunës së egër për shpalljen e tyre të mbrojtur mbështeten në të dhënat e reja dhe në ato ekzistuese, të siguruar nga strategjia e plani i veprimit të biodiversitetit, nga rrjeti i inventarizimit dhe i monitorimit të biodiversitetit, si dhe nga burime zyrtare ndërkombëtare.

4. Llojet e faunës së egër përcaktohen me status mbrojtjeje, nëse plotësojnë, të paktën, njërin prej kriterëve të mëposhtme:

a) janë shpallur të mbrojtur nga instrumente ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) kanë një status ruajtjeje të pafavorshëm;

c) ka të dhëna të pamjaftueshme statistikore;



ç) popullatat kanë pësuar ulje drastike dhe, për pasojë, paraqitet një rrezik serioz për ruajtjen e mjedisit natyror;

d) shtrirja natyrore e llojeve është zvogëluar dhe ka ende mundësi të zvogëlohet në të ardhmen e afërt.

5. Ngarkohen ministria përgjegjëse për faunën dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË

Nr. 343/5, datë 5.11.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, nyja e Milotit”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si më poshtë vijon:

1. Për pasuritë e llojit “trual” dhe “arë”, vlerësimi është kryer bazuar në vendimin nr. 89,

datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtësë me funksion banimi dhe jobanimi”, vlerësimi është kryer sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,939,135.50 (gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTTI”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri					Sipërfaqja që shpronësohet						Objekti që shpronësohet					SHËNIME
				Zona	Numri	Sip.	Lloji		TOKË TRUALL		TOKE ARË		Banim		Soc.-ek.		VLERA		
				kadastr.	pasurisë	Totale	pasurisë	Sipër-faqja	Çmimi	Vlera	Sipër-faqja	Çmimi	Vlera	Sipërfaqja	Vlera	Sipër-faqja	Vlera	TOTALE	
						m²		e shpr. (m²)	(lek/m²)	lek	e shpr. (m²)	(lek/m²)	lekë	e shpr. (m²)	lekë	e shpr. (m²)	lek	(lek)	
1	GJERGJ	NIKOLL	PRENGA	2365	11/1	5760	ARË +TR.				169	321	54,249					54,249.00	Certifikuar
2	PJETER	MARK	HIDRI	2365	11/2	2500	ARË				197	321	63,237					63,237.00	Konf. nga ASHK-ja
3	GJIN	NIKOLL	BURAKU	2365	2/4	14280	ARË				2,328	321	747,288					747,288.00	Konf. nga ASHK-ja
4	MARK	PASHK	RICA	2365	1/4	10100	ARË				2,527	321	811,167					811,167.00	Certifikuar
5	ADRIANA	AVDYL	MARKU	2365	3/3	7200	ARË				2,138	321	686,298					686,298.00	Certifikuar
	JORGO	MUSA	MARKU																
6	NDUE	PRENG	TUCI	2365	10/18	7500	ARË				1,006	321	322,926					322,926.00	Certifikuar
7	PREN	NIKOLL	HIDRI	2365	11/20	1250	ARË				79	321	25,359					25,359.00	Urdhër sekuestroje
8	PRENG	LLESH	GJOKA	2365	9/1	1000	ARË				201	321	64,521					64,521.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
9	ALEKSANDER	BARDHOK	BIBAJ	2365	9/20	2500	ARË				242	321	77,682					77,682.00	Konf. nga ASHK-ja
10	BARDHOK, PRENE, ANTON, ALMA		BIBAJ	2365	9/19	6593	ARË				651	321	208,971					208,971.00	Konf. nga ASHK-ja
11	SHKELZEN	NIKOLL	GJERGJI	2365	9/23	2676.3	ARË				178	321	57,138					57,138.00	Konf. nga ASHK-ja
12	NDUE	NIKOLL	HIDRI	2365	11/21	1250	TRUALL+e ND.	130	294	38220								38,220.00	Union Bank (certifikuar)
13	BARDHOK	KOL	KOLA	3441	9/1	3360	ARË				161	278	44,758					44,758.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
15	GJET	NDU	GJETA	3441	9/52	8000	ARË				54	278	15,012					15,012.00	Konf. nga ASHK-ja
16	RAMIZ	MUHARREM	LAMA	3441	10/9	10172	ARË				1,800	278	500,400					500,400.00	Konf. nga ASHK-ja
17	SEHIT	RIZA	LAMA	3441	10/20	9072	ARË				377	278	104,806					104,806.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
18	FILIP	LLESH	KOLA	3441	9/6	1851	ARË				14	278	3,892					3,892.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
19	FLAMUR	KOL	KOLA	3441	9/2	2012	ARË				21	278	5,838					5,838.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
20	ZENEL	ALI	ZENELI	3441	9/35	1100	ARË				695	278	193,210					193,210.00	Certifikuar
21	NDOC	DED	BROZI	3441	9/46	6048	ARË				790	278	219,620					219,620.00	Konf. nga ASHK-ja
22	NAZMIE, ADELINA, ERMIRA	XHEVAHIR,	LAMA	3441	77/25	3600	ARË				1,120	278	311,360					311,360.00	Konf. nga ASHK-ja
23	HAJDAR	SALI	LAMA	3441	13/13	9088	ARË				201	278	55,878					55,878.00	Urdhër sekuestro (pa certifikuar)
24	HASAN	FASLLI	LAMA	3441	14/24	8512	ARË				197	278	54,766					54,766.00	Konf. nga ASHK-ja
25	MURAT	RAMAZAN	LAMA	3441	77/7	12000	ARË				1,366	278	379,748					379,748.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
26	BESNIK	HAJREDIN	ÇAKONI	3441	22/2	1604	ARË				20	278	5,560					5,560.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
27	HAMDI	ISLAM	LIKA	3441	9/33	3006	ARË				70	278	19,460					19,460.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
28	MHILL	NDUE	NDRECA	3441	6/50	5744	ARË + TR.				592	278	164,576					164,576.00	Konf. nga ASHK-ja
29	ABAZ	HASAN	TAFILI	3441	79/1	17000	ARË				978	278	271,884					271,884.00	Konf. nga ASHK-ja
30	PAJ	HASAN	TAFILI	3441	8/1	12610	ARË				1,236	278	343,608					343,608.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
31	PJETER	LEK	LALA	3441	78/5	7000	ARE				1,021	278	283,838					283,838.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
32	GJERGJ	MARK	SEFGJINI	3441	76/4	17430	ARE+ TR.				2,684	278	746,152					746,152.00	Konf. nga ASHK-ja
33	MARK	NDUE	BARDHI	3441	70/19	15180	ARE+ TR.				728	278	202,384					202,384.00	Konf. nga ASHK-ja
34	BASHKËPRONARËT BROZI GJËÇAJ LLESHAJ			3441	9/43	715	ARE+ TR.				72	278	20,016					20,016.00	Konf. nga ASHK-ja



35	SHTET			3441	6/43	3402	ARË				243	0	0					0.00	Konf. nga ASHK-ja
36	DRITAN	PRENG	GJETA	3441	9/56	8000	ARË				1,219	278	338,882					338,882.00	Konf. nga ASHK-ja
	ADELINA	PRENG	GJETA																
37	ZAN	IBRAHIM	LIKA	3441	9/34	4008	ARË				85	278	23,630					23,630.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
38	KASEM	FASLLI	LAMA	3441	9/29	4008	ARË				100	278	27,800					27,800.00	Konf. nga ASHK-ja
39	ZEF	NDU	NDRECA	3441	6/41	1489	ARË				243	278	67,554					67,554.00	Konf. nga ASHK-ja
40	NDUE	MARK	GJOKA	3441	5/7/1	4730	ARË				478	278	132,884					132,884.00	Konf. nga ASHK-ja
41	ZEF	GJET	BROZI	3441	9/48	3871	ARË + TR.				111	278	30,858					30,858.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
42	GJOVALIN	ZEF	BROZI	3441	9/49	2940	ARË				74	278	20,572					20,572.00	Konf. nga ASHK-ja
43	MARK	PRENG	SHEBJA	3441	6/26	6930	ARË				195	278	54,210					54,210.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
44	SHTET			3441	5/8/2	9547	ARË				496	0	0					0.00	Konf. nga ASHK-ja
45	RAM	RESHIT	ISUFI	3441	5/12	3680	ARË				184	278	51,152					51,152.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
46	RAMAZAN	SHAQIR	ISUFI	3441	5/13	3969	ARË				193	278	53,654					53,654.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
47	SINON	BAFTIAR	ISUFI	3441	5/14	5460	ARË				275	278	76,450					76,450.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
48	HUME	AHMET	KUQI	1677	22/32	1982	ARË				569	291	165,579					165,579.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
49	PASHK	BARDHOK	KOLA	1677	22/37	3612	ARË				245	291	71,295					71,295.00	Konf. nga ASHK-ja
50	ALTIN	GJON	BIBA	1677	28/62	1500	ARË				18	291	5,238					5,238.00	Konf. nga ASHK-ja
	ANDUELA	MIHAL	BIBA																
51	ÇALOK	SUL	KASMI	1677	26/34	3000	ARË				71	291	20,661					20,661.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
52	MARSIDA	HAKI	ZENELI	1677	26/30	2902	ARË				1,283	291	373,353					373,353.00	Konf. nga ASHK-ja
53	PRENG	PJETER	BIBA	1677	29/1	8960	ARË				599	291	174,309					174,309.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
54	FRROK	PRENG	BIBA	1677	29/2	8960	ARË				175	291	50,925					50,925.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
55	MARJAN	GJON	BIBA	1677	29/30	8136	ARË				525	291	152,775					152,775.00	Konf. nga ASHK-ja
56	BEG	PAJ	HAXHIU	1677	28/43	4758	ARË				505	291	146,955					146,955.00	Konf. nga ASHK-ja
57	NEZIR	DERVISH	HALILI	1677	24/22	4800	ARË				614	291	178,674					178,674.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
58	HASAN	KURT	KASMI	1677	3/41	7400	ARË				278	291	80,898					80,898.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
59	SHTET			1677	7/34	2370	ARË				128	0	0					0.00	Konf. nga ASHK-ja
60	ABAZ	AHMET	MURATI	1677	2/7	6700	ARË				154	291	44,814					44,814.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
61	ISMAIL	XHEMAL	KASMI	1677	2/16	10730	ARË				550	291	160,050					160,050.00	Konf. nga ASHK-ja
62	JETMIR	PAL	KOLAJ	1677	27/69	3564	ARË +TR.+ND.	53	295	15635	337	291	98,067		388.02	3,511,676.64		3,625,378.64	Konf. nga ASHK-ja
63	FRROK	VORF	PALAJ	1677	28/65	8700	ARË				287	291	83,517					83,517.00	Konf. nga ASHK-ja
64	BAJRAM	SHABAN	HYSENI	1677	5/19	1724	ARË				230	291	66,930					66,930.00	Konf. nga ASHK-ja
65	XHAFFERR	HASAN	LAMA	1677	4/33	1904	ARË				462	291	134,442					134,442.00	Konf. nga ASHK-ja
66	GANI	ALI	LAMA	1677	4/31	2008	ARË				167	291	48,597					48,597.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
67	MARTINAJ E.M			1677	28/16	4000	ARË				172	291	50,052					50,052.00	Konf. nga ASHK-ja
68	NIKOLL	DED	BRUKA	1677	6/30	10266	ARË +TR.				965	291	280,815					280,815.00	Certifikuar
	DRANE	FRROK	BRUKA																
69	AHMET	VESEL	LAMA	1677	3/20	3100	ARË				232	291	67,512					67,512.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
70	MARJAN	GJON	BIBA	1677	29/55	1650	ARË				118	291	34,338					34,338.00	Konf. nga ASHK-ja
71	LLESH	GJERGJ	GEGA	1677	23/26	8050	ARË				500	291	145,500					145,500.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
72	ERVIN	SKENDER	KASMI	1677	25/40	3937	ARË				31	291	9,021					9,021.00	Konf. nga ASHK-ja



	LULZIME	XHEMAL	KASMI																
73	HYSEN	HASAN	KASMI	1677	7/18/1	200	TRUALL+ND.	72	295	21240				52.8	1,430,855			1,452,094.86	Shpronësohet për 52.8 m², sipas objektit faktik ne terren (pa certifikuar)
74	GJET	LLESH	LLESHI	1677	28/59	1540	ARË				147	291	42,777					42,777.00	Konf. nga ASHK-ja
75	MARTINAJ E.M			1677	29/48	2202	ARË +TR.+ND.				420	291	122,220					122,220.00	Konf. nga ASHK-ja
76	SABA	SUL	KASMI	1677	8/25	3240	ARË				588	291	171,108					171,108.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
77	AHMET	VESEL	LAMA	1677	4/29	2116	ARË				297	291	86,427					86,427.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
78	SHITET			1677	27/34	2345	ARË				960	291	279,360					279,360.00	Konf. nga ASHK-ja
79	FATMIR	NDUE	GJOKA	1677	29/67	1898	ARË				242	291	70,422					70,422.00	Konf. nga ASHK-ja
	KLONDINA	ZEF	GJOKA																
80	SHAQIR	BAFTIAR	SULA	1677	5/39	5105	ARË + TR.				389	291	113,199					113,199.00	Konf. nga ASHK-ja
81	FATBARDH	SHAQIR	SULA	1677	5/41	4862	ARË				381	291	110,871					110,871.00	Konf. nga ASHK-ja
82	LEK	NDREC	BIBAJ	1677	10/31	6620	ARË				230	291	66,930					66,930.00	Konf. nga ASHK-ja
83	BARDHOK	DED	BIBAJ	1677	11/32	2630	ARË				336	291	97,776					97,776.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
84	TAHIR	SEFER	KASMI	1677	27/58	1040	ARË				183	291	53,253					53,253.00	Konf. nga ASHK-ja
85		SHITET		1677	9/31	1715	ARË				253	0	0					0.00	Konf. nga ASHK-ja
86	PREN	FRROK	PALAJ	1677	28/67	7925	ARË				188	291	54,708					54,708.00	Konf. nga ASHK-ja
87	NIKOLL	PJETET	SHQALSI	1677	6/1	1000	ARË				223	291	64,893					64,893.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar)
88		SHITET		1677	11/33	1330	ARË				149	0	0					0.00	Konf. nga ASHK-ja
SHUMA TOTALE								255.00		75,095.00	42,010.00		11,921,509.00	52.80	1,430,854.86	388.02	3,511,676.64	16,939,135.50	

Shënime:

- Për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, vlerësimi është kryer bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.
- Për pasuritë e llojit “ndërtësë me funksion banimi dhe jobanimi”, vlerësimi është kryer sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë